



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 61, datë 07.02.2024

PËR

**PEZULLIMIN NGA DETYRA TË MAGJISTRATES {...}, ME FUNSKION
GJYQTARE PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM TIRANË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 140 pika 3, gërma b), dhe nenin 147/a, pika 1, germa b) të Kushtetutës, në nenin 61, pika 2, gërma b), në nenin 97, pika 1, germa a) të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, në nenin 151, pika 1, germa b) dhe 155 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pasi shqyrtoi informacionin e ardhur, me shkresën nr. 3147 prot., datë 07.02.2024 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, mbi propozimin e Komisionit Disiplinor,

V E N D O S I :

1. Pezullimin nga detyra të magjistrates {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve, afat i cili fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet magjistrates {...}, sipas kërkesave të nenit 98, pika 1 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, si dhe bëhet publike në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR